



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E KULTURES
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 867 Prot.

Tiranë, më 06.07 2018

VENDIM Nr. 134, datë 27.06.2018

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003. "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), VKM Nr. 280, datë 01.04.2015 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave të dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi në ndërtimet me leje". Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.6 të datës 27.06.2018, pasi shqyrtoi kërkesën e ALUIZNI-it Durrës për konfirmim nga KKA, për vijimin e procedurës së legalizimit të objektit "Godinë banimi 1 kat" të Z. Anxhelo Prokop Leka, në zonën kadastrale 8512, blloku nr. 9, i cili pozicionohet brenda zonës arkeologjike "B" të qytetit të Durrësit,

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e ALUIZNI-it Durrës për konfirmim nga KKA, për vijimin e procedurës së legalizimit të objektit "Godinë banimi 1 kat" të Z. Anxhelo Prokop Leka, në zonën kadastrale 8512, blloku nr. 9, i cili pozicionohet brenda zonës arkeologjike "B" të qytetit të Durrësit.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al